



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1111/3 Prot.

Tiranë, më 09 . 07 . 2026

V E N D I M

Nr. 190 , datë 09 . 07 . 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 146 Regj. datë 12.06.2026, të shtetasit K. P, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, nga ana e personave përgjegjës që administrojnë faqen e internetit “PatronazhLeaks”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, subjekti ankues informon se, në faqen e internetit “PatronazhLeas”³ janë publikuar fotografi të tijat dhe të një familjari pa pëlqimin e tyre. Krahas fotografive janë publikuar informacione dhe përshkrime që lidhen me bindjet e tij politike, e për të cilat pretendon që cenojnë dinjitetin, reputacionin, jetën e tij private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Ankuesi pretendon se ky publikim përbën trajtim diskriminues për shkak të bindjeve të tij politike dhe krijon stigmatizim publik kundrejt tij. Z. P shprehet se përmbajtja e publikuar ka shkaktuar shqetësim moral dhe emocional, si për të, ashtu dhe për familjen e tij, duke u cenuar figurën e reputacionin në komunitet.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ <https://patronazhleaks.com/>

Në përfundim të ankesës, z. P kërkon nga Komisioneri, kryerjen e hetimit të rastit, konstatimin e diskriminimit për shkak të *bindjeve politike*, ndërprerjen e praktikës diskriminuese, si dhe rekomandimin për marrjen e masave rregulluese.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti ankues, identiteti i subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, “PatronazhLeaks”, nuk rezulton i provuar. Në këto kushte, Komisioneri realizoi *kryesisht* verifikime në faqen zyrtare të internetit të “PatronazhLeaks”, me qëllim verifikimin e identitetit të këtij subjekti.

- Nga verifikimet e kryera nga Komisioneri në faqen zyrtare të internetit, rezultoi se “PatronazhLeaks” është një faqe ku ekspozohen publikimet e bëra nga personazhe apo

individë të njohur publikë ose jo, që sipas citimit të përdorur aty, ka për qëllim “*Ekspozimin e patronazhistëve që mbështesin këtë klasë politike të kalbur*”. Nga këqyrja që i bëhet faqes nuk evidentohen të dhëna lidhur me Administartorin/administratoret e saj apo se si mund të kontaktohen e identifikohen ato.

- Me shkresën nr.1111/1 prot, datë 16.06.2026, Komisioneri iu drejtua me kërkesë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP-it), nëse dispononte informacion në lidhje me emrin e administratorit të portalit “PatronazhLeaks” dhe adresën ku mund të kontaktohet.

- Me shkresën nr.1458/1 prot, datë 23.06.2026, AKEP-i, informoi Komisionerin se:
Në cilësinë e administratorit të regjistrit të emrave të domaineve nën zonën “al”, AKEP administron domainin e nivelit të lartë “al”, përfshirë edhe domainet e nivelit të dytë “gov.al”, “mil.al”, “Com.al”, “net.al”, “org.al”, “edu.al”.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se nuk ka asnjë domain nën .al të regjistruar me emrin PatronashLeaks, e në këto kushte, AKEP, nuk disponon asnjë informacion në lidhje me të”.

Në nenin 33, pika 3/c, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “*Ankesa përmban, të paktën: ...c) subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin, ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij*”.

Komisioneri konstaton se, pavarësisht veprimeve të mësipërme verifikuese të ndërmarra nga ana e institucionit, nuk u bë e mundur identifikimi i subjektit kundër të cilit subjekti ankues ka paraqitur ankesën.

Komisioneri vëren gjithashtu se, vetë subjekti ankues ka detyrimin që të provojë para KMD-së se, ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim. Kalimi i barrës së provës nga viktimja e diskriminimit te autori i diskriminimit, lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij.

Më pas, KMD vijon me shqyrtimin e rastit për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga autori i pretenduar i diskriminimit janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se veprimet e ndërmarra prej tij nuk kanë qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim i përket fillimisht ankuesit, por *vetëm* nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin.

Ankuesi nuk solli prova e fakte se cilat ishin pasojat konkrete që i kishin ardhur nga përmbajtja e publikuar në faqen e “PatronazhLeaks”, duke cenuar figurën e reputacionin e tij dhe të familjes së tij në komunitet.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim dhe pasoja të shkaktura prej tij, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës. Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 146 Regj. datë 12.06.2026, të shtetasit K. P kundër faqes së internetit “PatronazhLeaks”, nuk duhet të pranohet, për sa kohë që subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk është identifikuar, si dhe në kushtet kur ankuesi nuk solli fakte e prova mbi diskriminim e pretenduar.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁴”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj⁵.

Komisioneri vlerëson se, *lidhur me pretendimin për cenim të të dhënave personale*, ky kërkim i z. P, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin nga KMD, pasi ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, mbikëqyrja e të cilit është në fushën e kompetencave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

PËR KËTO ARSYE :

⁴ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, Vendimi nr. 41, datë 13.02.2024, të KMD-së etj.

Bazuar në nenet 32 dhe 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranim e ankesës nr.146 Regj. datë 12.06.2026, të shtetasit K. P kundër faqes së internetit “PatronazhLeaks”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)